

VENDIM
Nr.14, datë 13.1.2006

**PËR NDRYSHIMIN DHE KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË NJË
OBJEKTI TË PORTIT TË PESHKIMIT, SHËNGJIN, NGA MINISTRIA E MJEDISIT,
PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE, MINISTRISË SË BRENDSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja "c" të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekti "Pjesë e hangarit" e portit të peshkimit në Shëngjin, së bashku me truallin funksional, me sipërfaqe 576 m², në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, sipas genplanit që i bashkëlidhet këtij vendimi, t'i kalojë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të ndjekin procedurat për transferimin e kësaj prone të paluajtshme.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe kryerregjistruesi i pasurive të paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

